



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 64/09

Prishtinë, më 18.11.2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Naser Osmani, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Armend Zemaj, Haki Shatri, Müfera Şinik, Suzana Novobërdaliu.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Hajdin Abazi, Besa Gaxherri dhe Xhevdet Neziraj.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma dhe Dashurie Canolli.**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Teki Shala, Aleksander Beetz, Ramadan Islami, James Spense, Diana Fecke, Jutta Albrecht nga GTZ, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, USAID, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/1192/L-104/1 për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nuklerare, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente I ftuar: Naim Maloku, kryesues grupit punues të Komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit kundër korrupsionit me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
- 4. Shqyrtimi i propozim - amendamenteve për Projektligjin nr. 03/L-170 për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale;**
- 5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për borxhet publike;**
- 6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, paraprkisht përshëndeti ekspertët e GTZ, znj. Fecke dhe z. Spense me të cilët komisioni ka mbajtur një seminar, në të cilin shkëmbyer përvojat për buxhetin, që mund të jenë të dobishme në këtë fazë të shqyrtimit të buxhetit të vendit. Më pas njoftoi se rendi i ditës është vazhdim i mbledhjes së kaluar, dhe kërkoi të deklarohen për miratimin e tij.

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/1192/L-104/1 për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nuklerare, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryesuesi, njoftoi se i ftuari për këtë pikë të rendit të ditës, ka lajmëruar se nuk mund të jetë i pranishëm në këtë mbledhje, andaj kërkoi që kjo pikë të shtyhet për në mbledhjen e radhës së komisionit.

Pas propozimit, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Në mungesë të kryesuesit të grupi punues i ftuar që të raportoj në mbledhje për amendamentet e propozuara nga komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Projektligji nr. 03/1192/L-104/1 për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nuklerare, shtyhet për në mbledhjen e radhës së komisionit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit kundër korrupsionit me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për projektligjin dhe amendament e komisionit funksional, lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin kundër korrupsionit dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i propozim - amendamenteve për Projektligjin nr. 03/L-170 për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale

Kryesuesi, njoftoi se në amendamentimin e këtij projektligji kemi pasur ndihmën e z. Teki Shala (eksperte i GTZ në mbështetje të punës së Komisionit), i cili ka përgatitur propozim – amendamentet në emër të komisionit. Përveç kësaj, propozim-amendamente lidhur me këtë projektligj kanë

propozuar dy deputetë. Deputetja znj. Nerxhivane Dauti dhe z. Riza Smaka, që do të jenë objekt diskutimi në këtë mbledhje.

Anëtarët e Komisionit miratuan propozim amendamentet e përgatitura nga z. Teki Shala, me modifikimin e disa prej tyre. Po ashtu miratuan propozim – amendamentet 2, 3, 4 dhe 5 e znj. Nerxhivane Dauti, ndërsa refuzuan propozim amendamentin 1 dhe 6. Ndërkaq propozim amendamentet e z. Riza Smaka nuk i miratuan. Kryesuesi propozoi që neni 23, riformulohet si në vijim: Ministri në afat prej 6 (gjashtë) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, propozimi i të cilit u përkrah njëzëri.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për borxhet publike

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R A P O R T

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar në parim projektligjin borxhet publike dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës që në leximin e parë, të miratojë në parim këtë projektligj.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010

Kryesuesi, theksoi se qëllimi i vënies së projektligji në rend dite është rekomandimi nga ana e komisionit për miratimin e tij në parim në Kuvend. Pas miratimit në parim, Komisioni do të merret me hollësisht me shqyrtimit dhe amendamentimin eventual të tij.

Haki Shatri, theksoi se nuk mund të përkrah miratimi në parim të këtij projektligji, pa marrë disa sqarime nga MEF-i, për disa çështje që nuk janë pasqyruar si duhet në këtë projektbuxhet. Prandaj unë përkrah rekomandimin që projektligji të kalojë në seancë plenare për diskutim, por jo edhe për miratim. Vërejtjet e mija do ti jap edhe në seancë plenare dhe do të kërkojë sqarime nga Ministri i MEF-it.

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për rekomandimin e komisionit, për mbështetjen në parim të këtij projektligji në seancën plenare të Kuvendit.

Pasi propozimit dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se gjashtë vota Për, dy Kundër (znj. Suzana Novobërdaliu, dhe z. Haki Shatri) dhe asnjë Abstenim, Komisioni me nxori këtë:

R A P O R T

- I. I rekomandon Kuvendit të Kosovës që në leximin e parë, të miratojë në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI